

## KËRKESEË PËR RISHQYRTIM

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: **Komuna e Deçanit**

Për Aktivitetin e Prokurimit: **631-21-2675-5-2-1** dhe nr te brendshem : **631-21-009-521**

Sa i përket tenderit për : **Ndërtimi i pendës për ujite në fshatin Vranoc, Deçan**

### 1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

”Menti“ Sh.p.k.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Banjë Istog

(Adresa)

Banjë

(Vendi)

044/503-665

(Numri Telefonit)

31.010\_Banjë

(Kodi postar)

049/\_503-665

(Numri i Faks-it)

Islam Shoshi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

mentishpk@gmail.com

(Adresa elektronike)

20.05.2021

(Data e parashtrimit të kërkesës)



### 2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

### 3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vandin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë ” apo “ Njoftimi për konkurs te projektimit ” dhe, nëse aplikohet “ Njoftimi për dhënie të Kontratës ”, “ Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit ” apo “ Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit ”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës ]:

- **Njoftimi per kontrate 06.05.2021 afati i fundit per ofertim 26.05.2021 ora 14:00**
- **Vlera e Aktivitetit e mesme e parapare : 172.000,00 €**
- **Kriteret e dhënjes :Tenderi i përgjegjshem me Çmimin më të ulët**

### 4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

**Para hapjes konform nenit 108/A , kerkesa per Ri-Shqyrtim te kritereve.**

### 5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

### 6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

**Neni 1 – Qellimi – i Lpp-së**

**Neni 7 – Barazia në Trajtim / Jo-diskriminim i Lpp-së paragrafi 2 , paragrafi 3 , paragrafi 4 , dhe paragrafi 6 .**

**Neni 28 – Specifikimet teknike i Lpp –së paragrafi 2**

**Neni 53 – Keresa per informacione shtese i Lpp-së**

**Neni 25 – Ofrimi i Informacioneve shtesë i Rruopp**

**Neni 26 – Kriteret e perzgjedhjes i Rruopp**

### 7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

**Neni 1 Qellimi**, Bazuar ne nenin 1 te Lpp-së AK është e obliguar të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoritetetëve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla:

**AK nuk eshte ne perputhje me nevojat e Aktivitetit te Prrokurimit sepse disa nga kerkesat apo kriteret e kerkuara nuk korrespondojn me natyren e keti Aktiviteti te Prrokurimit.**

**Neni 7 , Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi**

1.Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente.

2.Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik.

3.Pa e cenuar paragrin e mësipërm, autoritetit kontraktues posaçërisht i ndalohet që të përcaktojë nevojat e veta që duhet të përbushen, specifikojë lëndën që do të prokurohet, ndajë ose përbledh sasitë ose artikujt e tjerë që duhet të prokurohen, duke zgjedhur një procedurë të prokurimit, ose duke vendosur një kërkesë ose kriter të përgjedhjes ose specifikacion teknik që në ndonjë mënyrë ka për qëllim të favorizojë ose diskriminojnë kundër njërit ose më shumë operatorëve ekonomik.

4.Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojoë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrëthanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ ndërmjet operatorëve ekonomik.

6. Gjatë udhëheqjes së aktivitetetëve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; (i) pjesëmarrjen sa më të gjerë të mundshme të operatorëve të interesuar ekonomik lidhur me çmimin dhe lëndën e prokurimit; (ii) publikimin e rregullt, dërgimin dhe/ose disponueshmërinë e të gjitha njoftimeve, ftesave, informacioneve dhe dokumenteve që kanë të bëjnë me aktivitetin e prokurimit në përputhje me këtë ligj; (iii) eliminimin e praktikave, kritereve, kërkesave dhe specifikimeve teknike që diskriminojnë në favor ose kundër një ose më shumë operatorëve ekonomik; (iv) që të gjitha specifikimet teknike dhe të gjitha kërkesat për përgjedhje dhe dhënie, duke përfshirë rëndësinë relative të se cilës kërkesë dhe kriter të tillë, si dhe metodat e përgjedhjes dhe dhënieve të saktësohen në njoftimin e kontratës ose konkursit përkatës të projektimit, në ftesën për tender ose pjesëmarrje dhe/ose në dosjen e tenderit; (v) që asnjë kërkesë, kriter, specifikim që nuk është saktësuar kështu, të mos përdoret në procesin e përgjedhjes ose dhënieve, dhe (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përbajtjesore të kushteve, kritereve dhe specifikimeve përkatëse

**Diskriminimi mund te ndodhe ne momentin qe nje OE i cili do te kishte mundesi te realizimit te kontrates ka kapacitete teknike dhe financiare, dhe nuk mund ti plotesoj kriteret e kerkuara per me shume i referohemi paragrafeve 4 deri 11 tek pershatshmeria profesionale si Noterizime qe nuk kane te bejn me natyren e prokurimit dhe Kapaciteti teknik profesional kerkesa 3 dhe 4.**

**Neni 28 – Specifikimet teknike parografi 2 thotë :**

Autoriteti kontraktues do t'i përpilojë specifikimet teknike në atë mënyrë që ato të janë në përputhje me qëllimin e prokurimit dhe të drejtuara drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë për të gjithë operatorët e interesuar ekonomik dhe tenderuesit. Autoriteti kontraktues është veçanërisht i ndaluar që të hartojë specifikime teknike që favorizojnë ose diskriminojnë një ose më shumë operatorë ekonomik.

**Ne ketë raste ne si OE e konsiderojm se jemi të diskriminuar dhe nese shiqohen kontratat paraprake ne me disa AK kemi realizuar projekt identike dhe me plotë sukses.**

**Neni 53 Sigurimi i informatave shtese siaps paragrafit 1 si dhe Neni 25 Rruopp , shkelje per mostrajtim adekuat duke mos u pergjigjur ne kerkeses tone per informacione shtese te dt.17.05.2021 te ngarkuar ne e-prokurim ( Deshmi konfirmimi i dergeses) si dhe Refuzimi i po te njejtes date.**

**Neni 26 Rruopp , shkelje sepse sipas keti rregulli nje AK mund te kerkoj kerkesa Minimale per perm bushje te kriterit 26.2 duke pas parasysh qe te ofroj mundesi sa me te gjere dhe gjithëperfshirës te konkurimit.**

### **Arsyetim :**

Po kufizohet ne mase te madhe mundesia e nje perfshierje sa me te gjere te OE te cilet kane kapacitete humane dhe teknike per realizimin e projektit ne fjale *Kerkojm* nga AK – Komuna e Deçanit respektivishtë Menagjeri i prokurimit fillimishte te analizoj Kerkesen tone konform nenit 108/A te Lpp-së , dhe ne bazë të kopetencave qe ka ta Ri-Shqyrtoj vendosjen e kritereve dhe te jete i kujdeshem qe ne baze te kerkesave per realizim te projektit edhe njesia kerkuese ne kete raste Drejtoria per Bujqesi te mos vendos kerkesa diskriminuese te procedoj ne bazë legjislacionit dytesor per parashtrimin e Kerkeses per Rishqyrtim pran AK bazuar ne F03 Rregullat për paraqitje te kërkesës për rishqyrtim pranë Autoriteteteve Kontraktuese Ne kemi vepruar ne baze te nenit 4 **nen a** ), ndersa

Ju lutemi te veproni ne baze te nenit 6 **nen b**) dhe me pastaj pas shqyrtimit te Kerkeses sone te merrni VEDNIM bazuar ne nenin 8 pika **8.1.2 ii.**

Duke eliminuar kriteret diskriminuese te panevojshme , si **Dozer D 7** , duke mos dhen asnjë Alternative per nje mjete te ngjashhem , dhe si e tille e konsiderojm te panevojshme per nje Aktivitet te tille ku AP me vlere te mesme ( 172.000,00 € ) dhe duke kerkuar makineri qe nuk perkon me nevojat e realizimit te projektit kjo eshte e pa justifikushme , dhe ate dy here te Noterizohet si liste dhe si paisje .

**Kërkesa 4. 1(një) Buldozer D7,7(shtatë),dy(2) Eskavator,5(pesë) Kamion kiper,**

**Dëshmi 4. Dëshmi mbi pronësinë (apo të marrjes me qira) të mjeteve, stabilimenteve dhe pajisjeve teknike dhe kapacetetve të nevojshme për plotësimin e kërkesave (sipas listes se kerkuar në FDT). OE duhet të prezentoj dëshmi Listën e noterizuar si dhe te gjitha deshmitë përkatëse te noterizuara nga Noteri (librezat e qarkullimit valide, DUD-at doganor, faturat dhe kontratat e shiteblerjes) për pajisjet, të cilat jane te domosdoshme qe t'i angazhoj për këtë projekt. (Pajisjet duhet të Noterizohen).**

**Deri diku te arsyeshme 2 Eskavator dhe 5 Kamion Kiper , ndersa**

**Plotësishte te pa-arsyeshme**

1. **Buldozer D 7** ( duke mos ofruar alternative nga prodhuesit te tjere )
2. Nese paisja eshte ne pronesi atehere pse te kerkohet Noterizim i listës dhe Noterizim i paisjes

Mendimi jonë , formulim gabim i kerkeses dhe Deshmis nr. 4 si dhe favorizim per ndonje OE i cili mund ta posedoj nje makineri me kete shenjë **“D 7”** me kete AP.

Duke u bazuar ne Lpp-në si dhe legjislacionin dytesor ju nuk keni te dreje ne kerkesa te tillë sepse.

**Kërkesa 3 Menagjeri i Projektit - Inxhinier i dip.i ndërtimtarisë, drejtimi konstruktiv 5 vite përvojë punë pas diplomimit. Të ketë dëshmi se ka menaxhuar së paku dy (2) projekte për punë të ngashme**

Deshmia 3 Diploma (e noterizuar), - Kontrata e punës me ofertuesin (kopje e noterizuar) - leter referencat:

**Sipas Legjislacionit ne fuqi dhe referuar Lpp-së si dhe Interpretimit nga KRPP-ja ne lidhje me stafin esencial , duhet te pranohen :**

**Kontrata e punës e deshmuar ( mundet te jete si deshmi nga ATK-ja ) ose Parakontrata per projektin ne fjale : Noterizimi i saj eshte i pa-arsyeshem.**

Duke u bazuar ne ate siq u pershkrua me larte lusim AK qe te gjitha keto kriteri ti eliminoj dhe te pranoj kerkesen tone per Ri-Shqyrtim si te bazuar dhe te vazhdoj me Aktivitetin ne fjale me Korrigjim te njoftimit dhe DT ne daten dhe kohen e caktuar per hapje ( te gjitha keto mund te korigohen permes formularit B-54 )

## **8. Dëmet materiale**

*Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.*

*Sipas LPP-së nr.04/L-042 ne mund te jemi fitues potencial te keti AP dhe ky kufizim ndoshta per pjesemarrje sa me te gjere mund te kete ndikim te drejtëperdrejtë ne mos realizim te kontrates se mundshme dhe kompanis tonë si dhe kompanive te tjera po ju kufizohet e drejta per pjesemarrje ne realizimin e fitimit nga puna e jonë apo e tyre ne kete projekt , prandaj nese respektohet ligji i prokurimit publike dhe kriteret e kerkuara nga Autoriteti Kontraktues ne mund te jemi fitues , ne te kunderten demet jane te konsiderueshme si per ne ashtu edhe per OE te tjere dhe keshtu me apo pa qellim mund te demtohet buxheti i Republikës së Kosovës.*

## **9. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura**

*Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:*

- a) një kopje të publikimit të Njoftimit për Kontratë
- b) një kopje të publikimit të DT.
- c) Kopje e paramases .
- d) Një kopje te informacioneve shtese
- e) Pergjigjeja – Refuzimi i kerkese per Sqarime
- f) Një Kopje te Korrigjimeve te gabime ne kriteret
- g) Dosja e Re e permiresuar ne disa pika .